



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.706/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Drenas, të paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, për Zgjedhjet lokale të 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.10.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**HUDHËN** të pa palejuara ankesat Anr.706/2021, Anr.707/2021, Anr.708/2021, të datës 21.10.2021, të paraqitura nga Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për verifikim të rezultateve në vendvotimet 0301X, 0317E, 0309/E, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 21.10.2021, ka pranuar ankesat Anr.706/2021, Anr.707/2021, Anr.708/2021, nga Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Drenas, në të cilat pretendon se në fshatin Krajkov Komuna e Drenasit, në Shkollën fillore Gani Elshani 0309/E, në Shkollën fillore Halil Bajraktari në Drenas 0301X, dhe në vendvotimin 0317E, nuk më janë numëruar votat të cilat familjarët e mi deklarojnë së më kanë votuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

## **Ankesa është e palejuar**

Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, Paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet me të cilat pretendon se në fshatin Krajkov Komuna e Drenasit, në Shkollën fillore Gani Elshani 0309/E, në Shkollën fillore Halil Bajraktari në Drenas 0301X, dhe në vendvotimin 0317E, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljës së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesave nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljës të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**A nr. 706/2021 më datën 22.10.2021**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*